



B a n k a e S h q i p ë r i s ë

B U L E T I N I Z Y R T A R

v ë l l i m i 21, n u m ë r 1, s h k u r t 2019

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 21

numër 1

shkurt 2019

Data e botimit: 20.02.2019

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 09.01.2019, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kapitalin rregulator të bankës"" 7
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 09.01.2019, "Për miratimin e emërimit të drejtorit të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës të bankës së Shqipërisë" 9
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 09.01.2019, "Për emërimin e Zëvendësgubernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë" 10
4. Licencë nr. 44, datë 16.01.2019, "Për të vepruar si subjekt financiar jobankë në Republikën e Shqipërisë" 11
5. Licencë nr. 176, datë 01.02.2019, "Për të vepruar si shoqëri kursim-krediti në Republikën e Shqipërisë" 13
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 06.02.2019, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 15
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 8, datë 06.02.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian" 17
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 06.02.2019, "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a." 19
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 06.02.2019, "Për shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, prerja 1000 lekë" 21
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 06.02.2019, "Për shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, prerja 10.000 lekë" 22
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 06.02.2019, "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa vlerave materiale në Bankën e Shqipërisë dhe asgjësimin e tyre" 23
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 06.02.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për vënien në dispozicion të Bankës së Shqipërisë të të dhënave për qëllime statistikore" 25
13. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, datë 06.02.2019, "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit" 26
14. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 06.02.2019, "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga Balfin sh.p.k. të 88.95 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Tirana sh.a." 27



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 2, datë 09.01.2019

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR KAPITALIN RREGULLATOR
TË BANKËS"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 59, pikat 2 dhe 8, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 69, datë 18.12.2014, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) në nenin 42, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i) përmbajtja e shkronjës "a", ndryshon në:
"a) 6.75% të kapitalit bazë të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;",
 - ii) përmbajtja e shkronjës "b", ndryshon në:
"b) 9% të kapitalit të nivelit të parë ndaj ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;"
 - b) në Aneksin 1, Tabela "Raportet dhe Nivelet e Kapitalit", ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

RAPORTET DHE NIVELET E KAPITALIT

Nr.	Zëra	Vlera
1.	Raporti: Kapitali Bazë i Nivelit të Parë/Ekspozime të Ponderuara me Rrezikun	≥6.75%
2.	Raporti: Kapitali i Nivelit të Parë/Ekspozime të Ponderuara me Rrezikun	≥9%
3.	Raporti i Mjafueshmërisë së Kapitalit	≥12%

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 3, datë 09.01.2019

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË
SISTEMEVE TË PAGESAVE, KONTABILITETIT DHE FINANCËS TË
BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në bazë të nenit 43, shkronja "h", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 18, pika "b" shkronja "i", të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 21, datë 16.05.2007, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005, "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe propozimit të Departamentit të Burimeve Njerëzore bazuar në urdhrin e Guvernatorit me nr. prot.86, datë 08.01.2019, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë emërimin e zj. Ledia Bregu në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 4, datë 09.01.2019

**PËR
EMËRIMIN E ZËVENDËSGUVERNATORIT TË PARË TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe me propozim të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë dhe të emërojë zj. Luljeta Minxhozi në detyrën e Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

LICENCË
Nr. 44, datë 16.01.2019

PËR TË VEPRUAR SI SUBJEKT FINANCIAR JOBANKË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendim nr. 01, datë 17.01.2013, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; Banka e Shqipërisë i jep shoqërisë "TIRANA CAPITAL TRADE" sh.p.k. licencën për të ushtruar veprimtaritë financiare të përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



Tiranë më 16.01.2019

ANEKS

LICENCA NR. 44

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR "TIRANA CAPITAL TRADE" SH.P.K.

Subjekti Financiar Jobankë "TIRANA CAPITAL TRADE" sh.p.k., në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendim nr.01, datë 17.01.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, është i licencuar të kryejë veprimtarinë financiare si më poshtë:

1) Faktoring.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË

LICENCË
Nr. 176, datë 01.02.2019

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI KURSIM-KREDITI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 52/2016, datë 19.05.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërive të Kursim-Kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin nr. 104, datë 5.10.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; shoqërisë "TIRANA INVEST KREDIT 2000" i jepet licenca për të vepruar si shoqëri kursim-krediti në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon shoqërisë së kursim-kreditit "TIRANA INVEST KREDIT 2000" të kryejë veprimtaritë e përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

DREJTOR

DENIZ DERALLA



Tiranë më 07.02.2019

ANEKS

LICENCA NR. 176

VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR SHOQËRINË E KURSIM-KREDITIT "TIRANA INVEST KREDIT 2000"

Shoqëria e Kursim-Kreditit "TIRANA INVEST KREDIT 2000" sh.p.k, në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.05.2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin nr. 104, datë 05.10.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është e licencuar të kryejë veprimtaritë financiare si më poshtë:

- 1) Pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive ndaj anëtarëve të shoqërisë.

DREJTOR

DENIZ DERALLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 6, datë 06.02.2019

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES
DHE TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË
KREDISË NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.00 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 0.1 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.9 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 8, datë 06.02.2019

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR PËRFAQËSIMIN LIGJOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN PËR HARMONIZIMIN E VROJTIMEVE TË BESIMIT
KONSUMATOR DHE TË BIZNESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 28, 29 dhe 113 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; dhe bazuar në propozimin e Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Parë, zj. Luljeta Minxhozi, për përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit të Komisionit Evropian, si dhe për nënshkrimin e të gjithë dokumentacionit në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij programi, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Të shfuqizojë vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, nr. 76, datë 7.10.2015, sipas së cilit me përfaqësimin ligjor të Bankës së Shqipërisë në këtë Program autorizohej zj. Elisabeta Gjoni.
3. Ngarkohet Zëvendësguvernatori i Parë, zj. Luljeta Minxhozi, me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 9, datë 06.02.2019

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË
FINANCIARE SHITESË NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE,
ALBANIA SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit"; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 18, pika 8, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 11.03.2009, e ndryshuar; pikës 6, të shtojcës 1, të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36 datë 26.05.2010; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shitesë të ndërmjetësimit në sigurime, në cilësinë e agjentit në sigurime.
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a, pas paraqitjes të licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 10, datë 06.02.2019

PËR
SHTYPJEN E KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR,
PRERJA 1 000 LEKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 14, të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 07.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor të prerjes 1 000 Lekë, në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e kartëmonedhave, të jetë viti 2019.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të Aneksit 1, që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 11, datë 06.02.2019

**PËR
SHTYPJEN E KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR,
PRERJA 10 000 LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 14, të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 07.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor të prerjes 10 000 Lekë, në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e kartëmonedhave, të jetë viti 2019.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të Aneksit 1, që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 13, datë 06.02.2019

PËR
NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË DISA VLERAVE MATERIALE NË
BANKËN E SHQIPËRISË DHE ASGJËSIMIN E TYRE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 7 dhe 9 të rregullores "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 117, datë 09.11.2016, i ndryshuar; të propozimeve të Komisionit të Vlerësimit dhe Nxjerrjes Jashtë Përdorimit të Aktiveve të Qëndrueshme në Bankën e Shqipërisë, ngritur me Urdhrin e Guvernatorit nr. 3999, datë 30.07.2018; si dhe me propozim të Departamentit të Administrimit dhe Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, sipas Aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë asgjësimin e vlerave materiale të nxjerra jashtë përdorimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Administrimit për ndjekjen e procedurave të asgjësimit, në përputhje me rregulloren "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.117, datë 09.11.2016, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, të bëjë veprimet përkatëse në përputhje me parashikimet e rregullores "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 117, datë 09.11.2016, i ndryshuar.

5. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 14, datë 06.02.2019

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS
BANKËS SË SHQIPËRISË ME DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
DOGANAVE, PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË BANKËS SË
SHQIPËRISË TË TË DHËNAVE PËR QËLLIME STATISTIKORE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe bazuar në propozimin e Guvernatorit dhe të Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Dytë, zj. Natasha Ahmetaj, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për vënien në dispozicion të Bankës së Shqipërisë të të dhënave për qëllime statistikore.
2. Ngarkohet Departamenti i Statistikave Financiare me zbatimin e të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 15, datë 06.02.2019

**PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS
BANKËS SË SHQIPËRISË DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
POLICISË SË SHTETIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes dhe të Guvernatorit, Këshilli Mbiqëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Dytë, zj. Natasha Ahmetaj, për nënshkrimin e marrëveshjes teknike midis Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit "Për ruajtjen dhe sigurimin e ambienteve të Bankës së Shqipërisë, vlerave monetare në lëvizje dhe bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve".
2. Ngarkohet Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 17, datë 06.02.2019

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK
PËR ZOTËRIMIN NGA BALFIN SH.P.K. TË 88.95 PËR QIND TË
KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS TIRANA SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të shkronjës "gj" të pikës 1 të nenit 24, si dhe të nenit 25 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.03.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 18 të Shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.05.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 88.95 për qind të aksioneve me të drejtë vote, të kapitalit aksionar të Bankës Tirana sh.a. nga Balfin sh.p.k. me kusht paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të miratimit të Hellenic Financial Stability Fund (HFSF) për shitjen e aksioneve të Bankës Tirana sh.a.
2. Ngarkohet Banka Tirana sh.a., të paraqesë në Bankën e Shqipërisë njoftimet e palëve të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes:
 - a) të hartojë një program specifik për mbikëqyrjen e Bankës Tirana sh.a. dhe t'a paraqesë për miratim në mbledhjen e radhës të Këshillit Mbikëqyrës;
 - b) të ruajë të pandryshuara normat mbikëqyrëse në zbatim për Bankën Tirana sh.a. për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe të likuiditetit për një periudhë, të paktën, 2-vjeçare.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
5. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
6. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë të njoftimit që do të bëjë Banka e Shqipërisë për plotësimin e kushtit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
KESHILLI MBIKEQYRES

V E N D I M

NR. SA DATE 13.07.2009

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org
www.bankofalbania.org
Tirazhi: 200 kopje

MIRATIMIN E RR...
SHITBJEREVERE...
neneve 1,14,15,16,18, si...
1997 "Për Bankën e...
Këshilli Mbi...